

## SHPALLJA E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS

Nr.	Pozicioni i punës	Struktura e interesuar/ Forca	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me dosje	Intervista	Fillimi	Mbarimi
1	<b>Specialist i infrastrukturës dhe admin rrjeti</b>	Reparti Ushtarak nr.6640, ASNI	Tiranë	Pa afat	Po	Po	22.05.2023	25.05.2023

<b>1.Pozicioni i punës:</b> Specialist i infrastrukturës dhe admin rrjeti, në Seksionin e IT, në Qendrën Fikse TIK, në Repartin Ushtarak nr.6640.
<b>2. Kodi i pozicionit:</b> N/A
<b>3. Reparti/Institucioni:</b> Reparti Ushtarak Nr.6640, Agjencia e Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit.
<b>4. Vendi:</b> Tiranë
<b>5. Paga:</b> VKM nr.187, datë 08.03.2017, i ndryshuar
<b>6. Lloji i kontratës së punës:</b> Pa afat
<b>7. Data e fillimit të aplikimit:</b> 22.05.2023
<b>8. Data e mbylljes së aplikimit:</b> 25.05.2023
<b>9. Mënyra e aplikimit:</b>  Për të aplikuar kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit, të cilin do ta gjejnë në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes, në adresën <a href="http://www.mod.gov.al">www.mod.gov.al</a> . Formulari pasi plotësohet, së bashku me dokumentacionin përkatës, do të dërgohet në:  <i>Drejtorinë e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve</i>  <i>Ministria e Mbrojtjes, Rruga e Dibrës</i>  <i>Tiranë</i>

## 10. Dokumentet e aplikimit:

Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- kërkesën;
- formularin e aplikimit;
- fotokopje të kartës së identitetit;
- diplomën e shkollës së lartë të noterizuar sëbashku me listë notash;
- fotokopje të patentës nëse ka;
- dëshmi profesioni nëse ka;
- certifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja
- raport mjekësor;
- fotografi me përmasa 4x6, 2 copë dhe 9x12 2 copë;
- dëshmi penaliteti;
- vërtetim nga gjykata;
- vërtetim nga prokuroria;
- librezë pune;
- jetëshkrimin (CV)
- Letër motivimi
- formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në faqen e internetit të MM-së në adresën elektronike [www.mod.gov.al](http://www.mod.gov.al) (linku: *Baza ligjore/Akte ligjore/ Integriteti i personave që ushtrojnë funksione publike/formulari i vetdeklarimit*)

## 11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:

- a) të ketë shtetësinë shqiptare;
- b) të jetë jo më pak se 18 vjeç;
- c) të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
- d) të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kriterëve të miratuara;
- ç) të jetë i aftë për punë nga ana shëndetësore;
- e) të mos jetë i/e dënuar me burg me vendim gjykate të formës së prerë për kryerje të një krimi;
- dh) të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

## 12. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

- a. Grada/Titulli: Civil/specialist
- b. Arsimi : Informatikë, Elektronikë, Teknologji Informacioni.
- c. Kualifikimi: bachelor/master
- d. Trajnimi: Trajnim në fushën e kërkuar
- e. Eksperiencia në Punë: Të ketë eksperiencë pune mbi 3 vjet në fushën e TI.
- f. Gjuha e huaj: Anglisht
- g. Kërkesa të tjera specifike: Njohuri te mira kompjuterike, njohuri mbi programet e monitorimit te paketave te rrjetit kompjuterik. Të ketë njohuri të mira në konfigurimin e pajisjeve te network(Router-Switch) dhe Firewall. Te kete kurse të ndryshme në interes të detyrës funksionale dhe në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, si: Comptia (Network+ Security+), ITIL, CCNA.

- h. Niveli i certifikatës së sigurisë: Sekret. Te plotesoje kriteret për tu pajisur me certifikate të sigurimit të personelit, sipas VKM nr.188/2015.

### 13. Përshkrimi i punës:

**Deklarimi i pozicionit:** Specialist i infrastrukturës dhe admin rrjeti përgjigjet për organizimin dhe drejtimin e punës për një funksionim sa më të mirë të rrjeteve kompjuterik si dhe siguron integrimin e sistemeve të ndryshme ndërmjet tyre. Është përgjegjës për sigurimin e funksionimit të nyjeve lidhëse ndërmjet rrjeteve kompjuterike në nivel L3 (switch-router) si dhe është përgjegjës për menaxhimin e Firewall në të dy rrjetet.

#### Detyrat kryesore:

1. Administron dhe menaxhon konfigurimet në nivel L3 (switch-router) dhe Firewall për të gjitha nyjet e shpërndarjes në rrjetet e Forcave të Armatosura.
2. Implementon planin e menaxhimit të konfigurimeve në sistemet kompjuterike si dhe bën kontrollin e ndryshimeve dhe ruajtjen e rekordeve të tyre.
3. Të integroj nga ana networking të gjitha mjediset e transmetimit (mikrovale, fibër optike, etj).
4. Të njoh arkitekturën dhe infrastrukturën e sistemeve kompjuterike të FARSH.
5. Krijon modelet e sigurisë për pajisjet e network-ut duke garantuar instalimin dhe shpërndarjen e tyre në sistem.
6. Raporton tek eprori i drejtpërdrejtë për çdo parregullsi apo shkelje që ai konstaton nga kushdo dhe raportimet që ka marrë nga vartësit në lidhje me shkeljet, parregullsitë dhe ngjarjet e jashtëzakonshme.
7. Bashkëpunon me specialist serveri dhe administrator sistemi si dhe përgjigjet për sistemin e monitorimit duke e mbajtur në gatishmëri dhe të përditësuar.
8. Të njoh procedurat e vendimmarrjes dhe të jetë i aftë për punën në grup.
9. Të njoh procedurat standarte të NATO-s në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit.

### 14. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një **komision vlerësimi** i përbërë nga 3 (tre) veta.  
Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- përzgjedhjen paraprake;
- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Njësia e Burimeve Njerëzore verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe

përcakton kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit. Vetëm kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësonë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i tyre do të bëhet nga komisioni përkatës.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), të cilat ndahen:

- a. 40 pikë, për vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve;
- b. 60 pikë, për intervistën e strukturuar me gojë.

**Vlerësimi i dokumenteve** të kandidatëve përfshin:

- a. vlerësimin e jetëshkrimit (CV);
- b. vlerësimin e kualifikimeve akademike, profesionale dhe teknike;
- c. vlerësimin e trajnimeve;
- d. vlerësimin e eksperiencave të ngjashme të punës;

Pikët totale të vlerësimit të dokumenteve ndahen, si më poshtë:

- a. jetëshkrimi, 5 pikë;
- b. arsimimi/kualifikimi, 15 pikë;
- c. trajnimi, 5 pikë;
- d. eksperiencia/përvoja në punë, 15 pikë.

**Intervista**, zhvillohet me gojë me të gjithë kandidatët që janë përzgjedhur gjatë fazës së përzgjedhjes paraprake. Qëllimi i intervistës është të verifikojë aftësitë, motivacionin dhe aspiratat e çdo kandidati, si dhe përputhshmërinë e profilit profesional të kandidatit me pozicionin që do të mbulojë.

Intervista zhvillohet e strukturuar me qëllim që të sigurojë informacion të saktë rreth profilit profesional të kandidatëve. Ajo strukturohet në varësi të pozicionit që punonjësi do të mbulojë dhe eksperiencës.

Gjatë intervistës kandidatit i drejtohen disa pyetje nga anëtarët e komisionit, përgjigjet e të cilave vlerësohen me pikë. Çdo pyetje ka një sasi të caktuar pikësh, të cilat vlerësohen në varësi të përgjigjes. Në total intervista ka 60 pikë.

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.